



Në datat 13–15 prill 2026, në Tiranë u zhvillua Samiti IV i Diasporës, i cili mbledhi shqiptarë nga e gjithë bota në një platformë bashkëpunimi me fokus zhvillimin ekonomik, inovacionin dhe forcimin e lidhjeve me diasporën shqiptare.

AIDA mori pjesë në panelin “Diaspora, partner në biznes dhe inovacion”, ku Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, theksoi rëndësinë e diasporës shqiptare si një aset strategjik për zhvillimin ekonomik të vendit, jo vetëm në aspektin e investimeve, por edhe si burim ekspertize dhe urë lidhëse me tregjet ndërkombëtare. Gjithashtu, u evidentua pozicionimi gjithnjë e më konkurrues i Shqipërisë në rajon për tërheqjen e investimeve të huaja.

Në kuadër të samitit, përfaqësuesit e AIDA-s zhvilluan takime me biznese dhe investitorë të diasporës, të cilët shprehën interes konkret për investime në Shqipëri, duke e kthyer aktivitetin në një hapësirë të rëndësishme për krijimin e partneriteteve dhe mundësive të reja ekonomike.



SAMITI I IV I DIASPORËS: NDËRTIMI I NJË EKOSISTEMI DINAMIK

AIDA në Konferencën e Biznesit Gjermani-Shqipëri | 30 Prill 2026, Berlin

Më 30 prill 2026, në ambientet e Haus der Deutschen Wirtschaft u zhvillua Konferenca e Biznesit Gjermani-Shqipëri, një takim i rëndësishëm mes përfaqësuesve institucionalë dhe komunitetit të biznesit nga të dy vendet.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në këtë aktivitet duke organizuar workshop-in me temë "Mundësitë dhe Lehtësitë për Investime në Shqipëri – si dhe Mbrojtja e Investimeve".

Workshop-i u hap nga Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, e cila prezantoi rolin e Gjermanisë si një partner strategjik ekonomik për Shqipërinë, si dhe angazhimin e AIDA-s në promovimin dhe lehtësimin e investimeve në vend.

Gjatë workshop-it u prezantuan zhvillimet kryesore ekonomike në Shqipëri, sektorët me potencial të lartë zhvillimi, infrastruktura strategjike dhe instrumentet mbështetëse për investitorët e huaj në faza të ndryshme të procesit të investimit.

Pjesëmarrja në këtë konferencë shërbeu si një mundësi për të prezantuar klimën e investimeve në Shqipëri dhe për të nxitur interesin e komunitetit të biznesit gjerman për bashkëpunime



AIDA në Albite Conference | 20 Prill 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në Albite Conference – 1st Edition, organizuar nga Albchef – Albanian Chefs Network, një aktivitet i fokusuar në rolin e gastronomisë dhe turizmit në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit.

Në panelin "Beyond Destinations", diskutimet u përqendruan te turizmi si një përvojë që shkon përtej udhëtimit tradicional, duke lidhur kulturën, identitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ekspertë dhe përfaqësues institucionesh ndanë perspektiva mbi potencialin e turizmit si nxitës i investimeve dhe urë lidhëse mes komuniteteve.

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, theksoi rëndësinë e turizmit si instrument i diplomacisë kulturore dhe vlerën e përvojave autentike, veçanërisht atyre të lidhura me gastronominë dhe traditat lokale, në promovimin e Shqipërisë dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Diskutimet evidentuan potencialin e Shqipërisë për të zhvilluar një model turizmi të qëndrueshëm dhe konkurrues, të bazuar jo vetëm në bukuritë natyrore, por edhe në kulturën, autenticitetin dhe eksperiencën që ofron vendi për vizitorët.

Albite Conference vuri në fokus turizmin përtej kufijve tradicionalë.



AIDA pjesë e Panairit “Ditët e Bujqësisë” | 28-30 Prill 2026, Lushnjë

AIDA përmbylli me sukses pjesëmarrjen në Panairin “Ditët e Bujqësisë”, i zhvilluar në Lushnjë në datat 28-30 prill, duke prezantuar programet dhe instrumentet mbështetëse për SME-të, promovimin e produkteve “Made in Albania” dhe mundësitë për ndërkombëtarizimin e bizneseve shqiptare. Gjatë panairit, stenda e AIDA-s mirëpriti përfaqësues institucionesh dhe biznese nga sektorë të ndryshëm të agro-përpunimit, agroturizmit, vajit të ullirit dhe bimëve aromatike, duke forcuar bashkëpunimin për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe rritjen e eksporteve shqiptare.

Gjatë ditës së parë të panairit, AIDA prezantoi edhe platformat për bizneset (financë, eksporte) si dhe informoi për fondin 2026 për SME-të që do të menaxhojë. Stenda tërhoqi prodhues të vajit të ullirit dhe bimëve aromatike, të cilët kërkuan informacion për mbështetjen e agjencisë. Panairi vijon edhe në ditët në vijim, duke ofruar promovim, rrjetëzim dhe zhvillim të sektorit bujqësor.

Interes i veçantë u tregua për fondet mbështetëse dhe programet e promovimit të eksporteve që AIDA do të menaxhojë.

AIDA në Kosova Finance Forum | 27-28 Prill 2026, Prishtinë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në Kosova Finance Forum, i cili u zhvillua në datat 27-28 Prill në Prishtinë, duke mbledhur aktorë kyç të politikëbërjes, biznesit dhe financës në rajon.

Në panelin me temë “Demografia, Produktiviteti dhe Rritja në Ballkanin Perëndimor”, Znj. Geraldina Fezaj, përgjegjëse sektori pranë Drejtorisë së Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit në AIDA, theksoi se demografia nuk është më thjesht një çështje sociale, por një faktor përcaktues për klimën e investimeve dhe rritjen ekonomike.

Ajo nënvizoi se investitorët janë gjithnjë e më të fokusuar tek disponueshmëria dhe cilësia e kapitalit njerëzor, duke e bërë fuqinë punëtore një element vendimtar në vendimmarrjen për investime.

Në përfundim, u theksua se sfidat demografike mund të shndërrohen në mundësi reale zhvillimi, përmes politikave të mirëkoordinuara dhe një vizioni të orientuar drejt produktivitetit dhe integritimit rajonal.



AIDA pjesë e inaugurimit të EUBACCI në Bruksel | 31 Mars 2026

AIDA mori pjesë në ceremoninë zyrtare të inaugurimit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë BE-Belgjikë-Shqipëri (EUBACCI), një iniciativë e rëndësishme që synon forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe lidhjeve tregtare mes Shqipërisë, Belgjikës dhe Bashkimit Europian, e realizuar me mbështetjen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Belgjikë.

Në praninë e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, agjencive të investimeve dhe kompanive ndërkombëtare, drejtoresha ekzekutive e AIDA-s znj. Laura Saro, prezantoi potencialet konkrete të investimeve në Shqipëri, duke theksuar rolin e saj si një partner strategjik për investitorët e huaj dhe një urë lidhëse mes politikave zhvillimore dhe nevojave të biznesit.

Themelimi i kësaj Dhome përfaqëson një hap strategjik për:

- Forcimin e pranisë së Shqipërisë në tregjet europiane;
- Tërheqjen e investimeve në sektorë prioritarë si teknologjia, ICT, energjia e rinovueshme dhe logjistika;
- Nxitjen e bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimin e informacionit.

AIDA pjesë e Tryezës Konsultative për Sipërmarrjen e Grave

Në ambientet e Xheko Imperial Hotel u zhvillua aktiviteti "Tryezë Konsultative me Palët e Interesit për Sipërmarrjen e Grave në Shqipëri", organizuar nga UN Women Albania me mbështetjen e UK Embassy in Albania dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit. Aktiviteti mbledhi përfaqësues të institucioneve publike, sektorit privat, shoqërisë civile dhe sipërmarrëse gra, me fokus identifikimin e barrierave dhe hartimin e rekomandimeve për politika më gjithëpërfshirëse.

Në fjalën e saj, ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj, theksoi rëndësinë e fuqizimit të sipërmarrjes së grave dhe angazhimit të AIDA-s në mbështetjen e bizneseve të drejtuara nga gra. Gjatë diskutimeve, znj. Sara Zotaj nga AIDA prezantoi rolin e institucionit në mbështetjen e sipërmarrjes përmes skemave të granteve, ndërkombëtarizimit të bizneseve dhe rritjes së aksesit në financë dhe informacion.



AIDA në MUSE-X | 17-19 Prill 2026

AIDA mori pjesë në MUSE-X Tirana 2026, ku u zhvillua workshop-i "Small Regions, Big Networks" në bashkëpunim me Enterprise Europe Network (EEN) dhe Unioncamere Puglia. Aktiviteti u fokusua në mënyrën se si rajonet e vogla mund të ndërtojnë ekosisteme të qëndrueshme në industrinë kreative dhe të forcojnë bashkëpunimin rajonal.

Gjatë workshop-it, znj. Fiona Beqiri, Drejtoreshë e Drejtorisë së Projekteve, NVM-ve dhe Eksporteve në AIDA, theksoi rëndësinë e këtyre platformave për zhvillimin e industrisë kreative në Shqipëri dhe krijimin e hapësirave reale për dialog dhe bashkëpunim.

Në kuadër të MUSE-X, AIDA organizoi edhe takimet B2B "From Puglia to the Balkans", duke bashkuar kompani nga rajoni i Puglias dhe kompani shqiptare të industrisë kreative. Takimet krijuan mundësi konkrete për rrjetëzim, shkëmbim idesh dhe partneritete të reja mes Shqipërisë dhe rajonit përtej Adriatikut.

Mes energjisë së MUSE-X, ku kreativiteti, biznesi dhe inovacioni bashkohen, këto ndërveprime janë një hap konkret drejt ndërtimit të urave të reja mes Shqipërisë dhe rajonit të Puglias.

Takim për zbatimin e programit SCORE | 16 Prill

Në kuadër të programit SCORE drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, mirëpriti në një takim znj. Rania Bikhazi, Specialiste e Lartë në Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), si dhe znj. Raelva Shabanaj, Koordinatorë Kombëtare e Projektit "Business Partnerships and Solutions for SDGs".

Githashtu në takim morën pjesë, Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, z. Enkelejd Musabelliu, si dhe Zëvendësministri i Financave, z. Andi Memeti.

Gjatë diskutimeve u trajtua zbatimi i programit SCORE në Shqipëri, si dhe rëndësia e përfshirjes së institucioneve shtetërore për të garantuar koordinimin dhe komunikimin efektiv ndërmjet agjencive përkatëse. U theksua roli i këtij programi në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe forcimin e dialogut social.

Në fokus të diskutimeve ishte edhe rëndësia e promovimit të praktikave të përgjegjshme të biznesit (RBC) dhe zbatimit të kujdesit të duhur për të drejtat e njeriut (HRDD), si elemente kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afrimin me standardet e Bashkimit Europian.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe avancimit të reformave që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe integrimin europian të vendit.



AIDA mori pjesë në mbledhjen e Këshillit të Investimeve | 20 Prill

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në mbledhjen e radhës së Këshillit të Investimeve, të drejtuar nga Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj, ku u diskutua mbi rëndësinë e sigurisë juridike të pronës si një element kyç për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e klimës së investimeve.

Gjatë mbledhjes, Drejtoresha e Kadastrës informoi mbi progresin në digjitalizimin e shërbimeve, një proces që synon lehtësimin e procedurave dhe uljen e kostove të regjistrimit të pronës për qytetarët dhe bizneset.

U theksua se reforma e pronës mbetet thelbësore për sektorë strategjikë si bujqësia, turizmi, ndërtimi dhe investimet, ndërsa përpjekjet për rritjen e transparencës dhe efikasitetit do të vijojnë si pjesë e një qasjeje të integruar për zhvillimin ekonomik të vendit.





IHD në Shqipëri | 2025 në nivele rekord

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, stoku i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Shqipëri ka vijuar trendin rritës, duke arritur nivele rekord historike.

Stoku i IHD-ve arriti rreth €17 miliardë, niveli më i lartë historik, me një rritje prej €1.6 miliardë krahasuar me vitin 2024 dhe duke përfaqësuar rreth 60% të PBB-së. Në këtë stok, Holanda mban peshën kryesore, duke reflektuar praninë e qëndrueshme të investitorëve ndërkombëtarë në vend.

Ndërkohë, fluksi vjetor i IHD-ve arriti në €1,635 miliardë, gjithashtu rekord historik, me një rritje prej €55 milionë nga një vit më parë. Investimet janë udhëhequr nga vende si Holanda, Italia, Kosova, Turqia dhe Austria, ndërsa sektori i pasurive të paluajtshme vijon të dominojë si destinacioni kryesor i kapitalit.

Për vitin 2025, stoku i Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri dominohet nga vendet evropiane. Ky zhvillim konfirmon jo vetëm hyrje të reja kapitali, por edhe rinovim dhe zgjerim të investimeve ekzistuese, duke forcuar pozicionin e Shqipërisë si një destinacion konkurrues për investime afatgjata.



AIDA mirëpriti përfaqësues të Ambasadës së Republikës së Uzbekistanit | 15 Prill

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, zhvilloi një takim zyrtar me përfaqësues të Ambasadës së Republikës së Uzbekistanit në Shqipëri, me seli në Vjenë, ambasadori z. Bakhtiyor IBRAGIMOV dhe sekretari z. Ulugbek KHODJAEV, ku në qendër të diskutimeve ishte thellimi i bashkëpunimit ekonomik dhe institucional ndërmjet dy vendeve.

Gjatë takimit u theksua rëndësia e forcimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe u diskutua mbi organizimin e takimeve me institucionet kryesore shqiptare dhe komunitetin e biznesit. AIDA rikonfirmoi angazhimin e saj për të mbështetur iniciativa që nxisin investimet dhe fuqizojnë bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar.



Takim mes AIDA-s dhe GIZ për programin ProSEED 3

AIDA zhvilloi një takim me përfaqësues të Qeverisë Gjermane përmes GIZ, në kuadër të fazës së ardhshme të programit ProSEED 3 (2027–2029). Diskutimet u fokusuan në forcimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare dhe përafrimin me politikat e Bashkimit Evropian.

Prioritetet kryesore përfshinë forcimin e NVM-ve dhe rolin të AIDA-s si One-Stop-Shop, mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat dhe rritjen e integritimit të bizneseve shqiptare në zinxhirët e vlerës gjermane dhe të BE-së përmes lidhjeve B2B.

Takimi përbën një hap të rëndësishëm në procesin vlerësues për përcaktimin e prioritetëve të fazës së re të projektit, duke riafirmuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm për ndërtimin e një ekonomie më konkurruese dhe të integruar.



Takim mes AIDA-s dhe partnerëve të EEN ALBANIA

Në 4 Prill, pranë ambienteve të AIDA-s u zhvillua një takim shumë produktiv mes partnerëve të EEN ALBANIA, ku diskutuam disa pika të rëndësishme që lidhen me bashkëpunimin, koordinimin dhe objektivat e përbashkëta për periudhën në vijim.

U fokusua tek forcimi i organizimit të aktiviteteve të ardhshme dhe përmirësimi i qasjeve tona të komunikimit dhe promovimit. U zhvilluan diskutime mbi lehtësimin e shkëmbimit të informacionit mes partnerëve, rritjen e dukshmërisë së rrjetit dhe mënyrat më efikase për të mbështetur bizneset pjesëmarrëse.

Një tjetër pikë thelbësore ishte harmonizimi i proceseve të raportimit dhe përditësimi i të dhënave në platformë për të siguruar transparencë dhe performancë të qëndrueshme. Së bashku po fuqizojmë ekosistemin e inovacionit dhe ndërkombëtarizimit të bizneseve shqiptare.



AIDA mbështet pjesëmarrjen e kompanive shqiptare në Macfrut 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), përmes projektit Enterprise Europe Network, mbështeti pjesëmarrjen e katër kompanive shqiptare në Macfrut 2026, një nga panairët më të rëndësishëm ndërkombëtarë për sektorin e frutave dhe perimeve, i zhvilluar në Rimini Expo Centre, Itali.

Panairi bashkoi aktorë nga i gjithë zinxhiri i vlerës së agrobiznesit, duke krijuar mundësi për rrjetëzim, bashkëpunim dhe zgjerim në tregje të reja. Nëpërmjet këtij misioni, kompanitë shqiptare përfituan agjenda të strukturuar takimesh B2B, kontakte të drejtpërdrejta me blerës dhe partnerë ndërkombëtarë, si dhe mundësi konkrete për zhvillimin e partneriteteve të reja.

AIDA vlerësoi bashkëpunimin me Unioncamere Emilia-Romagna në organizimin e takimeve B2B dhe riafirmoi angazhimin e saj për mbështetjen e ndërkombëtarizimit të bizneseve shqiptare.



Biznese që rriten me Mbështetjen nga AIDA

Thomas Enkelana

Nga përkushtimi ndaj cilësisë dhe inovacionit, Thomas Enkelana është pozicionuar si një ndër kompanitë lider në prodhimin e kafesë në Shqipëri.

Pas aplikimit në thirrjen e AIDA-s, kompania u shpall fituese dhe përfitoi mbështetje për përmirësimin e proceseve të saj.

Nëpërmjet një procesi auditimi profesional, kompania u certifikua me tre standarde ndërkombëtare, duke rritur besueshmërinë dhe cilësinë në treg.

Implementimi i këtyre standardeve solli përmirësim të imazhit të kompanisë, rritje të bazës së klientëve dhe zgjerim të gamës së produkteve të ofruara.

Një tjetër histori suksesi që dëshmon ndikimin e mbështetjes nga AIDA në forcimin dhe zhvillimin e bizneseve shqiptare.

Kompania Bonjo

Me traditë në prodhimin artizanal të glikove dhe reçelrave, Bonjo sjell në treg produkte autentike me shije të veçantë.

Pas njohjes me thirrjen e AIDA-s, kompania aplikoi dhe u shpall fituese, duke përfituar mbështetje për pajisje të reja.

Investimi në teknologji ka lehtësuar ndjeshëm procesin e prodhimit, veçanërisht në përpunimin e reçelrave, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e produkteve.

Nga një proces më i vështirë manual, sot puna është më e shpejtë dhe më e standardizuar, duke i dhënë mundësi kompanisë të rritet dhe të konsolidojë pozicionin në treg.

Një tjetër histori suksesi që tregon se si mbështetja e AIDA ndihmon bizneset shqiptare të zhvillohen dhe të modernizohen.

Diamant Bags

Nga një kompani e orientuar drejt eksportit, Diamant Bags po zgjeron me sukses praninë edhe në tregun vendas.

Me fokus fillestar në eksportet drejt Italisë dhe Greqisë, kompania ka ndërtuar një standard të lartë cilësie në prodhimin e çantave prej letre. Falë mbështetjes nga AIDA në kuadër të skemës së konkurrueshmërisë, kompania arriti të hyjë edhe në tregun shqiptar.

Sot, përveç klientëve vendas, Diamant Bags operon edhe përmes një platforme e-commerce dhe rrjeteve sociale, duke forcuar prezencën e saj në treg.

Një tjetër arritje e rëndësishme është certifikimi me standardin ndërkombëtar FSC, që dëshmon angazhimin për qëndrueshmëri dhe cilësi.

AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj (EYE)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj (EYE)

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/erasmus-per-sipermarresit-e-rinj-eye>

AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: GRAPPA Open Call (I4BE-Ingredients for the Bioeconomy)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: GRAPPA Open Call (I4BE-Ingredients for the Bioeconomy)

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/grappa-open-call-i4be>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: BIONetZero Open Call 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: BIONetZero Open Call 2026 (Agrifood and energy intensive industries)

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/bionetzero-open-call>



Ftesë për pjesëmarrje në Entrepreneur Expo 2026 – Tiranë

AIDA informon për zhvillimin e Entrepreneur Expo 2026, organizuar nga BLOconomy, që do të mbahet më 26 qershor 2026 në Piramidën e Tiranës.

Eventi është një nga forumet më të mëdha të sipërmarrjes në Shqipëri dhe rajon, duke mbledhur biznese, sipërmarrës dhe aktorë të ekosistemit ekonomik për rrjetëzim, ekspozim dhe diskutime mbi zhvillimin e biznesit.


Programi përfshin stenda ekspozimi, panele diskutimi dhe iniciativa të dedikuara për sipërmarrjen, duke synuar forcimin e bashkëpunimit dhe promovimin e inovacionit në ekonomi.

Një ditë e plotë në zemër të Tiranës, ku inovacioni, rrjetëzimi dhe vizioni bashkohen në një hapësirë unike.

Apliko tani ose kontakto në:
info@bloconomy.al
+355 69 40 80 233

 26 Qershor 2026  Piramida e Tiranës

Apliko: <https://bloconomy.al/expo-bloconomy/>



Ftesë për pjesëmarrje në AIREX 2026 – Baku, Azerbajxhan

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë shqiptare të sektorit të ndërtimit, pasurive të paluajtshme, arkitekturës dhe shërbimeve të lidhura të marrin pjesë në AIREX 2026, që do të zhvillohet më 4–6 nëntor 2026 në Baku, Azerbajxhan.

AIREX përfaqëson një nga ekspozitat më të rëndësishme ndërkombëtare për industrinë e real estate në rajon, duke mbledhur zhvillues, investitorë, agjenci imobiliare, institucione financiare dhe profesionistë të sektorit. Pjesëmarrja në këtë event krijon mundësi për promovimin e projekteve dhe shërbimeve, zgjerimin e rrjetit të kontakteve dhe krijimin e partneriteteve strategjike.

Eventi ofron takime të organizuara B2B, prezantime projektsh dhe mundësi konkrete për rritjen e dukshmërisë në tregjet ndërkombëtare dhe tërheqjen e investimeve të reja. Për më shumë informacion dhe aplikim, kompanitë e interesuara mund të vizitojnë faqen zyrtare të eventit: <https://airex.az/>.

 4-6 Nëntoror 2026  Baku, Azerbajxhan

Ftesë për pjesëmarrje në Forumin Ekonomik Poloni–Shqipëri | 18–19 Qershor 2026

Në kuadër të Sesionit të 8-të të Komisionit të Përbashkët Ekonomik Poloni–Shqipëri, më 18–19 qershor 2026 do të organizohet në Varshavë një Forum Ekonomik me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe të biznesit nga të dy vendet.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë shqiptare të shprehin interesin për pjesëmarrje në këtë forum, i cili synon të nxisë bashkëpunimin ekonomik dhe krijimin e partneriteteve të reja mes bizneseve shqiptare dhe polake.

Sektorët prioritarë përfshijnë energjinë, ndërtimin, industrinë ushqimore dhe ICT/BPO. Pjesëmarrja në forum ofron mundësi për zgjerimin e rrjetit të kontakteve ndërkombëtare, identifikimin e partnerëve potencialë dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregun polak.

📍 Varshavë, Poloni 📅 18–19 Qershor 2026

Shprehni interesin tuaj duke na kontaktuar në adresën e email-it : info@aida.gov.al

Ftesë për pjesëmarrje në Panairin e 6-të të Inovacionit 2026 | 26–30 Tetor 2026, në Jiangsu, Kinë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë shqiptare që operojnë në sektorët e teknologjisë, prodhimit të avancuar, inteligjencës artificiale, energjisë dhe mjedisit, shërbimeve digjitale, life sciences & medtech, edukimit dhe import-eksportit, të marrin pjesë në Panairin e 6-të të Inovacionit 2026, që do të zhvillohet në kuadër të Konferencës Sino-Euro Business Development Conference.

Eventi do të zhvillohet më 26–30 tetor 2026 në Jiangsu, Kinë, dhe synon të krijojë ura bashkëpunimi midis kompanive europiane dhe tregut kinez, duke ofruar mundësi konkrete për zhvillimin e biznesit dhe zgjerimin e eksporteve.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të zhvillojnë takime të dedikuara B2B, të identifikojnë partnerë potencialë për bashkëpunim teknologjik dhe furnizim, si dhe të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre në një platformë ndërkombëtare. Ky panair përfaqëson një mundësi të rëndësishme për kompanitë shqiptare për të hyrë në tregun aziatik dhe për të krijuar partneritete strategjike afatgjata.

📅 26–30 Tetor 2026 📍 Jiangsu, Kinë

Për më shumë informacion dhe aplikim vizitoni faqen e eventit:
<https://innovationfair.mikecrm.com/aMNRQIJ>